



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:119336
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05705447

Ac.nr.2444/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Ardian Ajvazi – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Lumni Sallauka e Bujar Muzaqi – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F..... A....., me procesmbajtësen I..... H....., në çështjen kontestimore të paditësit R..... Sh....., Rr. “Afrim Zhitija” në Podujevë, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.A..... S..... nga Podujeva, kundër të paditurit E..... (B.....) B....., Rr. “Afrim Zhitija” nr. 47 Podujevë, për shkak të pengim posedimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Podujevë C.nr.734/22, të datës 22.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 17.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurit E.....(B.....) B....., Rr. “Afrim Zhitija” nr. 47 Podujevë, ndërsa Aktvendimi i Gjyktës Themelore në Prishtinë Dega në Podujevë C.nr.734/22, i datës 22.03.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.nr.734/20, të datës 22.03.2023, ka vendosur në këtë mënyrë: **I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit R..... Sh..... nga Podujeva, si e bazuar. **II. VËRTETOHET** se i padituri E..... B..... nga Podujeva, e ka penguar paditësin R..... Sh..... nga Podujeva, në posedimin e lirë të fundit faktik të banesës e cila gjendet në Rr. “Ilir Konushefci, ngastra kadastrale O-71712062-27-3-1-0, vendi i quajtur Qytet, pjesë e ndërtesës, kati-P+0, me sipërfaqe prej 65.51m², e regjistruar në regjistrin publik të paluajtshmërive sipas fletës poseduese 08/580-02-60582, ZK Podujevë, në emër të paditësit, në atë mënyrë që me datë 16.05.2022, i padituri e ka penguar drejtpërsëdrejti paditësin në shfrytëzimin dhe posedimin e lirë dhe të qetë pronën e tij, e destinuar për banim. **III. DETYROHET** i padituri E..... B..... nga Podujeva, që në të ardhmen të jetë i përmbytur nga veprimet e tilla ose të ngjashme dhe mos ta pengojë në asnjë formë paditësin që të shfrytëzojë

dhe posedoj pronën e tij - banesën e evidentuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, si dhe që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë paditësit shumën në lartësi prej 441 Euro, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër këtij Aktvendimi, në afatin ligjor, i padituri ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktvendimi i atakuar ashtu që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pa bazuar, apo i njëjti të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi nuk parashtuar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me pjesën e aktvendimit të ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, në lidhje me nenet 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka vendosur si në dispozitiv të Aktvendimit të atakuar. Në arsytimin e tij ndër të tjera theksohet se në bazë të certifikatës pronësore me nr. 08-580-02-60582, e datës 15.10.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se ngastra kadastrale e evidentuar me nr. O-71712062-27-3-1-0 ZK Podujevë, banesa në sipërfaqe prej 65.51 m², lloji i njësisë - pjesë e ndërtesës, e destinuar për banim, evidentohet në emër të tani paditësit R..... Sh....., adresa Rr. "Ilir Konushëfci" në Podujevë. Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë të gjendjes faktike, gjykata në cilësi të palës ndërgjyqëse ka dëgjuar paditësin R..... Sh....., i cili lidhur me padinë deklaroi se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë nga i autorizuari i tij, ditën kur është bërë pengim posedimi ka qenë duke e pastruar banesën pronar i së cilës është tani e dy vite dhe aty ka qëndruar dy javë derisa me datë 16.05.2022 i padituri me dy djemtë e tij ka shkuar tek paditësi, me ç' rast i padituri ka qëndruar jashtë derisa dy djemtë e tij kanë hyrë brenda në banesën e tij dhe nuk kanë dalë derisa paditësi ka lajmëruar organet e rendit – Policinë e Kosovës. Për shkak të mosmarrëveshjeve që kishte me të paditurin, që nga ajo ditë, nuk ka shkuar më në banesën e tij, ndërsa tani jeton me qira. Gjykata gjithashtu në cilësi të palës ndërgjyqëse ka dëgjuar të paditurin E..... B....., i cili përgjatë shqyrtimit gjyqësor, ka kundërshtuar pretendimet e paditësit dhe ka mohuar të ketë penguar në posedim paditësin në shfrytëzim dhe posedim të pronës së tij, duke shtuar se me datë 16.05.2022 nuk është takuar fare me paditësin, ndërsa sa i përket pronës në fjalë, kërkoi që të arrijnë një marrëveshje me paditësin, ngase qëllimi i tij ka qenë që ta blejë këtë banesë mirëpo paditësi ia kishte ngritur çmimin kur e ka blerë dhe në rast se nuk mund të arrihet një marrëveshje mes tyre, atëherë nuk do ta lejojë paditësin asnjëherë që ta gëzoi të njëjtën dhe do tani e tutje do ta pengojë paditësin që të hyjë në pronën e tij pa një marrëveshje. Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), "*personi i cili ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*". Në nenin 113 paragrafi 1 të po të njëjtit ligj, është

paraparë se: “nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës....”, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë se: “nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”. Në bazë të provave të administruara lidhur me këtë çështje, është provuar se kërkesë padia e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovet në tërësi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, kjo për faktin se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, është provuar fakti se paditësi ka qenë në posedim të fundit faktik të banesës në vendin e quajtur –Qytet-Qytet, e cila paluajtshmëri është shënuar si ngastrës kadastrale O-71712062-27-3-1-0, ndërtesë me sipërfaqe prej 65.51 m², e regjistruar në regjistrin publik të paluajtshmërive sipas fletës poseduese 08/580-02-60582, ZK Podujevë, fakt i cili është vërtetuar edhe nga vet deklarimi i paditësit, i cili me datë 16.05.2022, derisa kishte qenë duke e pastruar banesën e tij me qëllim shfrytëzimi për kohën sa gjendet në pushime në Kosovë, dy djemtë e të paditurit janë futur brenda ndërsa i padituri ka qëndruar jashtë shtëpisë, ashtu që paditësi i është pamundësuar shfrytëzimi i lirë dhe i qetë i banesës së tij, ashtu që i njëjti menjëherë ka dalë jashtë me qëllim të shmangies së ndonjë konflikti të mundshëm verbal apo fizik. Faktin se i padituri ka penguar dhe vazhdon ta pengojë paditësin në shfrytëzimin e lirë dhe të qetë të pronës së tij, vërtetohet nga deklarimi i vet të paditurit, i cili përgjatë shqyrtimit gjyqësor sikurse edhe në seancën e datës 16.03.2023, ka deklaruar se nëse paditësi nuk dëshiron të arrijë një marrëveshje me të, atëherë nuk do ta lejojë të njëjtin asnjëherë që ta gëzojë banesën, se tani e tutje do ta pengojë që të hyjë në pronën e tij, andaj referuar dispozitës ligjore të nenit 113 par. 2 të LPDTS-së, fjalia e fundit e këtij neni i cili përcakton se: “.....Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”, paditësi me të drejtë ka kërkuar mbrojtje gjyqësore, me qëllim që të shfrytëzojë dhe posedojë i pa penguar dhe në mënyrë lirë dhe të qetë pronën, e përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi. Në lidhje me çështjen në fjalë, bazuar në nenin 480 të LPK-së, gjykata është e kufizuar vetëm në konstatimin dhe provimin e fakteve lidhur me gjendjen e fundit të posedimit dhe pengimit, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë më të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit, apo ndonjë të drejtë tjetër sendore. Andaj për gjykatën në këtë procedurë ka qenë irrelevant fakti se në emër të kujt evidentohet ngastrës kadastrale objekt i këtij shqyrtimi, ngase objekt i kontestit ka qenë pengim posedimi e jo vërtetimi i ndonjë të drejte tjetër subjektive civile sendore. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenin 452 par.1 të LPK-së, si dhe tarifën OAK-së për përfaqësime dhe atë për shpenzimet si në vijim: për padi dhe seancë shumë në lartësi prej 104 Euro, për dy seanca nga 135 Euro, për seancën e datës 07.02.2023 50% të vlerës së një seance, si dhe taksën gjyqësore në shumë prej 20 Euro, përkatësisht shumë e tërësishme e shpenzimeve procedurale në lartësi prej 441 Euro.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të

dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë as pretendimet tjera ankimore të cekura në ankesë nga paditësja.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit për shkeljet që i referohen dispozitave të procedurës kontestimore, për arsye se aktvendimi i atakuar është nxjerrë konformë dispozitës së nenit 142.2 dhe nenit 480 të LPK-ës, po ashtu nuk ka shkelje të tjera nga neni 182.2, pasi që arsyetimi i aktvendimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktvendimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktvendimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit. Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar në mënyrë të drejtën dispozitat materiale, kur ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për pengim posedim, për shkak se veprimi i të paditurit konsiderohet i jashtëligjshëm ndaj paditësit sipas dispozitave të LPDTS, e të cilat veprime i padituri i konfirmon edhe në seancën kryesore të datës 16.03.2023, në të cilën thekson se “...unë kërkoj që me palën paditëse të merremi vesh për një marrëveshje në mes veti se mua për atë banesë më ka ngritur çmimin kur e ka blerë i njejtë e po që se nuk ka marrëveshje unë s’do ta lejoj asnjëherë që ait ë ketë atë paluajtshmëri ta gëzoj të njejtën. Unë deklaroj se unë do ta pengoj edhe tash e pengoi paditësin me ardhë në pronën e tij pa një marrëveshje”, pra nga kjo shihet dhe vërtetohet akti i pengim posedimit të të paditurit ndaj paditësit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Andaj pretendimet e saj mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese që i ka cekur në arsyetim të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t’i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Përveç të cekurave më lartë, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë me të drejtë me rastin e vendosjes është mbështetur në nenin 480 i LPK-së, i cili shprehimisht thotë se: *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit.”* Në pajtim me atë që kjo dispozitë përcakton, gjykata e shkallës së parë, pas marrjes së lëndës në shqyrtim e ka shqyrtuar dhe vërtetuar gjendjen e fundit të posedimit, përfshirë këtu edhe faktin se i padituri ka kryer aktin e pengim posedimit në raport me paditësin. Si rrjedhojë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjshëm ka vendosur në këtë çështje kontestimore, kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke zbatuar me saktësi dispozitën e nenit 111 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), që tani është në fuqi, lidhur me nenin 480 të LPK-së, meqenëse është provuar fakti se i padituri e ka kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit.

Duke marrë parasysh të lartëcekurat, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur, të theksuara në ankesën e parashtruar, ku përveç që i padituri nuk ka ofruar ndonjë bazë mbi të cilën Gjykata e Apelit do të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, e njëjta, edhe për ato shkelje që i ka pretenduar, nuk ka dhënë sqarime të mjaftueshme, duke e bërë kështu ankesën të mangët në kuptim të nenit 178, pika c), të LPK-së.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, atëherë vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, për të cilin gjykata e shkallës së parë me të drejtë, është mbështetur në nenin 452, të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga të lartëcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), 200, 208 dhe 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2444/2023, me datën 17.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Ardian Ajvazi